

**URDHËR**  
**Nr. 204, datë 13.3.2013**

**PËR MIRATIMIN E MODELIT TË REGJISTRAVE, DOKUMENTEVE DHE FORMATEVE TË  
REGJISTRIMIT TË SUBJEKTEVE**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të vendimit nr. 765, datë 7.11.2012 “Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura” të Këshillit të Ministrave, si dhe të paragrafit 3 të urdhrit nr. 840, datë 26.12.2012 “Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura” të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave,

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e regjistrave, dokumenteve dhe formateve të regjistrimit të subjekteve, sipas pikave dhe modeleve bashkëngjitur këtij urdhri.

1.1 Librin e regjistrit për prodhuesit, importuesit dhe pikave të shitjeve të vajrave lubrifikante dhe industriale.

1.2 Librin e regjistrit për prodhuesit e mbetjeve të rrezikshme.

1.3 Librin e regjistrit për menaxhuesit e licencuar të grumbullimit, transportimit dhe trajtimit të mbetjeve të rrezikshme.

1.4 Etiketën “Ruajtje në ambalazh të veçantë” për vajrat e përdorura.

1.5 Dokument për marrjen në dorëzim të vajrave të përdorura.

1.6 Dokument për marrjen në dorëzim të mbetjeve të hidrokarbureve.

1.7 Dokument për marrjen në dorëzim të mbetjeve detare.

1.8 Format i regjistrimit për prodhuesit e vajrave.

1.9 Format i regjistrimit për gjeneruesit e vajrave të përdorura.

1.10 Format i regjistrimit për rikuperuesit e vajrave të përdorura.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Drejtoria e Kontrollit për Mjedisin, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Pyjeve, agjencitë rajonale të mjedisit, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, lidhur me procedurën e botimit në Fletoren Zyrtare të këtij urdhri, së bashku me modelet e regjistrave, dokumenteve dhe formateve të regjistrimit të subjekteve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE DHE  
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE  
Fatmir Mediu**